

Shpallen veprat e nominuara për çmimin e veçantë “Shuteriqi”

**(Konkurs i organizuar në kuadër të konferencës shkencore ndërkombëtare
“Nga Shteti i Arbërit tek Arbëria në shekujt e humanizmit europian”**

Juria e ngritur me vendim të Kryesisë së Akademisë së Shkencave për organizimin e konkursit për çmimin e veçantë shkencor “Shuteriqi”, themeluar në kuadër të konferencës shkencore ndërkombëtare “Nga Shteti i Arbërit tek Arbëria në shekujt e humanizmit europian”, në përfundim të afatit të pranimit të veprave të paraqitura për konkurrim, në mbledhjen e saj të datës 4 dhjetor 2023, diskutoi për prurjet e këtij konkursi dhe bëri vlerësimin teknik dhe shkencor të tyre, në përputhje me procedurat e parashikuara në rregullore.

Pasi u verifikua respektimi i kërkesave të jurisë për regjistrimin e veprave konkurruese për sa u takon dokumenteve shoqëruese dhe afateve, juria vlerësoi shkallën e plotësimin të kriterëve dhe kërkesave shkencore dhe bëri pikëzimin e secilës prej veprave në konkurrim në përputhje me to.

Juria vërejti me kënaqësi se ky konkurs, qëllimi i të cilit ishte vlerësimi prapavajtës dhe inkurajimi i botimeve të reja me karakter dokumentar e filologjik referuar kryesisht burimeve të panjohura, me kohështirje nga Shteti i Arbërit (1202) deri në Kuvendin e Arbërit (1702) dhe në ngjarjet që pasuan gjatë gjithë atij shekulli, rezultoi i suksesshëm.

Juria u shpreh falënderimet e saj gjithë autorëve pjesëmarrës në konkursin e çmimit shkencor “Shuteriqi” dhe pohon se numri i botimeve dokumentare dhe filologjike gjatë periudhës 2000-2022 ka qenë mjaft më i madh. Pavarësisht thirrjeve periodike të publikuara në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Akademisë së Shkencave, mungon në prurjet e këtij konkursi ndonjë titull më se i mirëpritur dhe me rëndësi cilësore. Ne do të kishim dashur që në këtë konkurrim të paraqitej edhe vëllimi “Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)” i Injac Zamputit, një model i punës për të tjerët, që ka fituar admirimin e studiuesve të disa brezave me shërbimin e tij të jashtëzakonshëm; botim që përmban dokumente të pabotuara mbi mesjetën shqiptare të botuara post mortem, nga “Albanisches Institut”.

Disa prej veprave të regjistruara për konkurrim pranë kësaj jurie, renditur sipas kohës së mbërritjes, të vlerësuara prej jurisë gjatë punës së saj, janë:

1. Gjon Berisha, *“Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e arkivës shtetërore të Dubrovnikut”*, bot. 2018, 431 faqe me 228 dokumente të panjohura;
2. Matteo Mandalà, *“Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike”*, bot. 2022, 670 faqe me 247 dokumente origjinale;
3. Virgjil Kule, *“Gjergj Kastrioti Skënderbeu, kryqtari i fundit”*, bot. 2012, 507 faqe;

4. Blerina Suta, “*Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)*”, bot. 2016, 126 faqe;

5. Irakli Koçollari, “*Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali pashë Tepelenës*” (vëll. I-IV), bot. 2019-2023, 2454 faqe me 1037 dokumente origjinale;

6. Ermal Nurja, “*Vlora në dokumentet osmane të arkivës së Stambollit*”, bot. 2022, 359 faqe, katalog i anotuar dokumentesh osmane për historinë e Shqipërisë në periudhën osmane, pjesë e një kolane prej katër vëllimesh;

7. Lida Miraj, “*Albania through traveller’s eyes*” (from the age of Humanism to the end of Second World War), bot. 2022, 490 faqe, anglisht;

8. Lucia Nadin, “*Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469*” (bot. i parë, italisht); “*Statutet e Shkodrës, nga gjysma e parë e shek. XIV, me shtesat deri më 1469*”, botim i dytë, dygjuhësh, “Onufri”, 2010; “*Statutet e Shkodrës, nga gjysma e parë e shek. XIV, me shtesat deri më 1469*”, botim i tretë, anastatik, (me parathënie nga Lucia Nadin dhe Pëllumb Xhufi), bot. IDK 2017, 254 faqe.

Në këtë mbledhje, pas diskutimeve të thelluara dhe me votim të fshehtë, juria vendosi që faza e fundme e konkursit të vijojë me katër vepra në nominuara për çmim, duke iu referuar rëndësisë së burimeve, cilësisë së përgatitjes për botim dhe sidomos rolit për ndriçimin e historisë kombëtare shqiptare. Fituesit do të shpallen më 27 dhjetor 2023.

Veprat e nominuara janë:

1. Lucia Nadin, “*Statutet e Shkodrës nga gjysma e parë e shek. XIV me shtesat deri më 1469*”; botim anastatik, Tiranë 2017, ed. IDK, 254 faqe me 99 dokumente origjinale;

2. Matteo Mandalà, “*Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike*”, 2022, 670 faqe me 247 dokumente origjinale;

3. Irakli Koçollari, “*Korrespondencë e dorëshkrime të Ali pashë Tepelenës*” (vol. I-IV), 2019-2023, 2454 faqe me 1037 dokumente origjinale;

4. Ermal Nurja, “*Vlora në dokumentet osmane të arkivës së Stambollit*”, Tiranë 2021, 359 faqe, katalog dokumentesh të anotuara nga arkivat osmane për historinë e Shqipërisë;

5. Blerina Suta, “*Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)*”, botim i vitit 2016, 126 faqe me 36 dokumente të reja.

Tiranë, 6 dhjetor 2023

Kryetari i jurisë

Akad. Adem Bunguri